

# PËRMBLEDHJE STUDIMESH

4

VITI I NËNDË I BOTIMIT

Dy mënyra për përpunimin e rezultateve të vrojtimeve gjeofizike  
me ndihmën e maqinave llogaritëse elektronike

- ALFRED FRASHËRI, GUDAR BEQIRAJ, YLLI VEJSIU -

Shteti ynë socialist, nën udhëheqjen largpamëse të Partisë së Punës të Shqipërisë, po pajiset gjithnjë e më shumë me mjete moderne për kërkime shkencore. E këtillë është edhe Qendra llogaritëse që është ngritur në vendin tonç.

Shfrytëzimi i maqinave llogaritëse elektronike krijon edhe për gjeofizikën mundësi të mëdha për të shpejtuar dhe për të saktësuar përpunimin e të dhënavë të vrojtimeve fushore dhe laboratorike si edhe për të thelluar e zgjeruar interpretimin gjeologo-gjeofizik të këtyre të dhënavë, çka ndihmon në rritjen e efektivitetit të kërkimeve gjeofizike.

Drejtimet kryesore, në të cilat mund të kryhen sot tek ne përpunimi dhe interpretimi i të dhënavë të gjeofizikës xherore me maqina llogaritëse elektronike janë:

1) Llogaritja e koeficientëve të skemave të profileve elektrike të gradientit të mesëm dhe e koeficientëve të tjerë, që shfrytëzohen në barazimet e përhapjes së fushës elektromagnetike;

2) Studimi statistikor i pote i rezultateve të përcaktimave petrografike të xherorit dhe të shkëmbinjve rrëthues, për të përcaktuar ligjësitë e ndryshimit të tyre; lidhja ndërmjet vetive fizike dhe përbërjes mineralogjiko-kimike të xherorit ose të shkëmbinjve; këto të dhëna bëjnë të mundur që të vlerësohen kufitë e ndryshëm fizikë dho të gjykohet mbi anomalitë e pritshme, duke studjuar edhe natyrën e fenomeneve të vrojtuara;

3) përpunimi statistikor i vlerave të parametrave fizikë të vrojtuara, kryerja e analizës së trendit dhe veçimi i anomalive, të shoqëruara edhe me vlerësimin për shkallën e besueshmërisë së tyre;

4) llogaritja analitike e anomalive të fushave fizike mbi trupa me trajta gjeometrike të njohura dhe të thjeshta;

5) transformimi i fushave etj.

Natyrisht, është akoma herët dhe kërkohet një punë shumë e madhe për të përvetësuar e për të përpunuar metodikat e nevojshme të përshtatshme për maqinat llogaritëse elektronike si dhe për hartimin e programeve për këto maqina. Megjithkëtë, për disa nga problemet më të thjeshta, janë hedhur hapat e para dhe janë marrë rezultate të mira. Janë hartuar programet për studimin statistikor të parametrave të matur, për filtrimin e anomalive të frekuencave të ndryshme, për llogaritjen e parametrit kompleks, për llogaritjen e gradientit të mëdiumit ati

## 1) FILTRIMI I ANOMALIVE TË FREKUENCAVE TË NDRYSHME

Fushat fiziqe shpeshherë janë shumë të turbullta. Kjo gjë është përshtatje mbivendosjes së anomalive të «frekuencës së lartë», që shkaktohen nga rojenitetet pranësipërfaqësore ose nga mikrorelievi, mbi anomalitë e kuencave të ulta», që shkaktohen nga objektet gjeologjike që kërkohen turbullim shprehet më dhëmbëzimin e grafikëve të intensitetit të fushave fisiologjike, i cili vështirëson interpretimin e tyre, pra krijon «zhurma» me nivel të frekuencës të caktuar.

Që të nxirren në pah anomalitë e shkaktuara nga objektet që kërkohen duhet të veçohen anomalitë me frekuencë të ulët nga ato me frekuencë të larta. Ky veçim mund të bëhet me mënyrën e «filtrimit».

Për të kryer filtrimin ekzistojnë shumë mënyra. Ne eksperimentim mënyrën e «mesatarizimit rrëshqitës». Ky filtrim lejon:

a) veçimin e anomalive me frekuencë të lartë nga ato me frekuencë të ulët, përcaktimin e amplitudës së secilës anomali dhe ndërtimin e grafikës përkatës të ndryshimit të tyre në të gjithë sheshin e relijuar;

b) shembujen e anomalive të rastit, që fiksohen në një ose në disa piketë një profili;

c) regjistrimin e anomalive të dobëta.

Mesatarizimi u krye me peshë në pikën e vrojtimit. Ai mund të jetë rrëshqitës linear ose sipërfaqësor, që, përkatësisht llogaritet me këto formulat:

$$\bar{A}_i = \frac{1}{2} \left( A_i + \frac{A_{i-1} + A_{i+1}}{2} \right); \quad (1)$$

$$\bar{A}_i = \frac{1}{2} \left( A_i + \frac{A_{i+2} + A_{i+1} + A_{i-1} + A_{i-2}}{4} \right); \quad (2)$$

ku:  $A$  – vlera e parametrave të matur në pikëtë  $i$ ;

$\bar{A}_i$  – vlera mesatare e parametrave të matur në piketën  $i$  të një profili të caktuar.

Skemat e kombinimit të piketave përmes mesatarizimit linear përkatësisht trëgohet në fig. 1.



Fig. 1: Skemat e mesatarizimit rrëshqitës linear.

Në rastin e mesatarizimit sipërfaqësor, formula llogaritëse ka trajtën:

$$\bar{A}_{i,j} = \frac{1}{2} \left( A_{i,j} + \frac{A_{i+1,j} + A_{i-1,j} + A_{i,j-1} + A_{i,j+1}}{4} \right). \quad (3)$$

Skema përkatëse e zgjedhjes së piketave është treguar në fig. 2.




Fig. 2: Skema përmes mesatarizimin rrëshqitës sipërfaqësor.

Nga barazimet e mësipërme duket se përmes pikëve dhëne mesatarja rrëshqitës formohet në rrugën e përgjithësimit të rezultateve të disa pikave para dheruar dhëse.

Me qëllim ilustrimi, më poshtë po ekspozojmë vetëm programin e mesatarizimit rrëshqitës sipërfaqësor, sepse ai është më tipik:

```

BEGIN REAL N1, N2, M1, M2; INPUT O: N1, N2, M1, M2;
BEGIN ARRAY A [N1:N2, M1:M2], AM [N1+1:N2-1, M1+1:M2-1];
INPUT 1:A;
FOR I := N1+1 STEP 1 UNTIL N2-1 DO
FOR J := M1+1 STEP 1 UNTIL M2-1 DO
AM [I, J] := 1/2 * A [I, J] + A [I+1,J] + A [I-1,J] + A [I,J-1] +
+ A [I,J+1];(4);
PRINT 3 : AM
END
END

```

Në këtë program, instrukcionet BEGIN dhe END përdoren përmes signalizuar fillimin dhe mbarimin e një bloku llogaritës.

Instrukcionet REAL N1, N2, M1, M2; INPUT O: N1, N2, M1, M2; i jepin maqinës, përkatësisht, numrin fillestar dhe numrin përfundimtar të piketave ( $N1, N2$ ) të çdo profili si dhe numrin fillestar dhe numrin përfundimtar të profileve ( $M1, M2$ ).

Instrukcionet ARRAY A [N1:N2, M1:M2], AM[N1+1:N2-1, M1+1:M2-1]; INPUT 1:A; shërbjnë përmes futjen në maqinë të vlerave të matura të parametrave përmes gjitha profilet si edhe përmes prezentit të maqinës përmes llogaritës vlerat e mesatares rrëshqitëse:

```

FOR I := N1 + 1 STEP 1 UNTIL N2 - 1 DO
FOR J := M1 + 1 STEP 1 UNTIL M2 - 1 DO
  AM [I,J] := 1/2 x(A[I,J] + (A[I+1,J] + A[I-1,J] + A[I,J-1]) +

```

[I, J + 1)]/4, është instruksioni qendror i programit. Aty janë pasqyruar me besnikëri si skema llogaritëse, ashtu edhe kufitë dhe rregulli i ndryshimit të numrave të piketave dhe të profileve.

Më në fund shtojmë se instruksioni PRINT 3:AM shërben për të nxjerrë në shtyp rezultatet e llogaritura nga maqina. Rezultatet dalin në trajtën e një pasqyre të ndarë në grupe sipas profileve.

Programi është shkruar në gjuhën ALGOL, me të cilën punon maqina elektronike kineze e tipit DJS-7. Ai presupozon që në të gjitha profilet numri i pikave të jetë i njëjtë. Në qoftë se të dhënat fushore nuk fillojnë e as mbarojnë në piketa me numër të njëjtë, atëhere, si numëri fillimi (N1) merret minëmumi i numrave fillestarë për të gjitha profilet dhe si numëri mbarimi (N2) merret maksimumi i numrave përfundimtare për të gjitha profilet. Për ato profile që janë më të shkurtëra se sa profili me fillim në N1 dhe me mbarim në N2, piketat në të cilat nuk janë bërë matje, mbushen me zero; pas llogaritjes këto piketa nuk merren parasysh.

Vlerat e matura të parametrit radhiten sipas profileve, duke nisur nga me numër rendor më të vogël.

Përpara se të futen në maqinë, vlerat duhet të kalojnë nëpër dy procese:  
1) në kodim dhe 2) në performim.

Mënyra e kodimit është mjaft e thjeshtë, sa që mund të krye nga një teknik që punon jashtë Qendrës llogaritëse. Për të sqaruar metodën e kodimit po tregojmë disa shembuj:

- 1) numri +32,49 kodohet 032492;
  - 2) numri -4,329 kodohet 143291;
  - 3) numri +34,8 kodohet 034802.

Sic shihet nga shembujt e paraqitur më sipër, shifra e parë paraqet shenjën e numrit 0 pér + dhe 1 pér shenjën -. Shifra e fundit paraqet numrin e shifrave që ndodhen para presjes dhjetore, kurse zona ndërmjetëse e kodit formohet nga shifrat e numrit. Në këtë mënyrë, të dhënat e koduara perforohen në një shirit letre të posacme. Ky i fundit futet në maginë pas hyrjes së programit.

Lloji i mesatarizimit linear apo sipërfaqësor zgjidhet në varësi të privijëzimit të anomalive dhe të përmasave të tyre. Kështu, për shembull, për të «sheshuar» lakoret e rezistencës së dukshme të matur me anën e profilimeve elektrike të kombinuara është përdorur mesatarizimi linear pesëintervalesh (fig. 3).

Nga fig. 3 vihat re se mesatarja rrëshqitëse fsheh maksimumet dhe minimumet; lakoresh e rezistencës së dukshme bëhen më të rregullta dhe «kryqë i drejtë» dallohet më qartë.

Të dhënat e relievimit sipërfaqësor magnetometrik, kur kanë ekzistuar anomali lineare, janë mesatarizuar në plan (fig. 4).

Né lakoret e mesatarizuara, qē tregohen nē fig 4-b, dalin mē nē pah ang-

malitë e vogla që shtrihen nëpër Pk 20 dhe 50, lakoret bëhen më pak të dhëmbëzuar dhe minimizohet ndikimi i heterogenitetave të padobishme.

Anomalitë e «frekuencës së lartë» nuk janë gjithnjë «zhurma» që duhen «shuar». Nganjëherë, ato pasqyrojnë ndërtimin shumëheterogjen të shkëmbinjve dhe mund të shërbejnë si shenjë dallimi i llojeve të ndryshme të shkëmbinjve. Prandaj, në këto raste, pas mesatarizimit rrëshqitës, për të gjitha nikat e vroitimit llogaritet madhësia e anomalisë me «frekuencë të lartë».

$$\Delta A_{i,j} = \bar{A}_{i,j} - A_{i,j}$$

Pastaj ndërtohet lakoja përkatëse për profilin. Për këto të dhëna, llogari tet edhe shmangja mesatare kuadratike:

$$\sigma = \sqrt{\frac{\sum_{i=1}^n (\Delta A_{i,j} - \bar{\Delta} A_{i,j})^2}{n}}; \quad (5)$$

e cila lejon që të vlerësohet në mënyrë sasiore ndryshueshmëria e parametrit fizik me frekuencë të lartë të matur mbi lloje të ndryshme shkëmbinjsh.

Mënyra e filtrimit të anomalive, me programin e mësipërm, u përdor edhe në dy sheshe të mëdha, për të përpunuar rezultatet e vrojtimeve magnetometrike dhe dha rezultate pozitive.

## 2) LLOGARITJA E PARAMETRIT KOMPLEKS TË FUNKSIONIT PËR-GJITHËSUES.

Në vendin tonë, për kërkimin e xehorëve përdoret një kompleks i gjerrë metodash qeofizike dhe gjeokimike.

Ekzistojnے disa ménryra pér tē paraqitut rezultatet e studimeve te shume metodave né trajtēn e një funksioni përgjithësues tē vetëm, duke llogaritur një **parametër kompleks (T)**. Né këtë parametër kompleks përgjithësohen parametrat e disa fushave fizike ose kimike tē vrojtuarra. Prandaj, para së gjithash, shmanget dallimet né përmasat e paramétrave tē matura tē se cilës fu- shë né veçanti. Pér këtë, né literaturën përkatëse rekomandohet (5) përdori- mi i treguesit tē **kontrastit**, sidomos pér anomalitë e dobëta, i cili llogaritet

$$\text{me formulén: } G_{i,j} = \frac{A_{i,j} - A_{sj}}{S(A_i)} ; \quad (6)$$

$k_{11}, A_{11}$  – vlera e parametrit i të matur në pikën j të vrojtimit;

Asi dhe  $S(A_i)$  - Përkatësisht vlera e sfondit dhe shmangja mesatare kua dratike e parametrit në zonën e fushës normale.

Ky tregues lejon të merret parasysh intensiteti i shfaqjes së sinjalit të dobishëm në sfondin e zhurmave, duke e paraqitur këtë intensitet në madhësi pa përmasa.

Nga llogaritjet teorike të bëra dhe nga eksperimentet e kryera eshte arritur në përfundimin se ky tregues duhet përdorur vetëm për  $S(A_i) > 1$ . Dhe kjo, jo sepse formula nuk është e vërtetë, por, sepse nuk është i drejtë zbatimi i saj në intervalin,  $0 \leq S(A_i) \leq 1$ . Nga formula 6, duket se kur  $S(A_i) < 1$ , treguesi i kontrastit zmadhohet sa më shumë që i afrohet zeros  $S(A_i)$ ; domethë në sa më homogjene bëhet fusha fizike. Ky përforcim i amplitudave të anomali




Fig. 3/a

Fig. 3: LAKORET E REZISTENCËS SË DUKSHME SIPAS PROFILEVE ELEKTRIKE TË KOMBINUARA.

A - Mbi një zonë me mineralizim sulfuresh me pikëzime në rajonin e Pukës.




Fig. 3/b

B - Mbi një zonë të mineralizuar me sulfure në rajonin e Kukësit.

1 - Pas mesatarizmit; 2 - para mesatarizmit.

a - Diabaze; b - spilite; c - zona e mineralizuar; ç - eksitusi.




Fig. 4/a




Fig. 4/b

Fig. 4: Lakoret e komponentit vertikal të fushës magnetike para mesatarizimit (a) dhe pas mesatarizimit sipërfaqësor (b).

ve «pa përmasa» i vendos ato në kushte të pabarabarta për metodat e ndryshme të përdorura, mbasi dihet se rëndësia e anomalisë varet jo nga shmanget mesatare kuadratike e parametrave të matura në zonën e fushës normale, por kushtëzohet, veç të tjerave, nga amplituda e saj mbi prag. Për të shmanget këtë të metë rekombinim që kur  $O < S(A_i) < 1$ , në vend të treguesit të kontrastit, të përdoret parametri i shprehur në milimetra:

$$K_{i,j} = \frac{A_{ij} - A_{si}}{Sh_A}; \quad (7)$$

ku:  $Sh_A$  – shkalla e paraqitjes grafike të parametrit  $A_i$ .

Për parametrat e kompleksit që kanë  $S(A_i) > 1$ , rekombinim të përdoret treguesi i kontaktit, që shprehet në milimetra:

$$K_{i,j} = \frac{A_{ij} - A_{si}}{Sh_A S(A_i)} \cdot \quad (8)$$

Në këtë mënyrë, njëkohësisht, merret parasysh intensiteti i shfaqjes së sinjalit të dobishëm në sfondin e zhurmave dhe anomalitë mbi përforcohen "artificialisht".

Funksioni i përgjithësuar i treguesit kompleks zgjidhet duke pasur parasysh që të sigurojë veçimin me qartësi të mjaftueshëm të sinjalit të dobishëm dhe, njëkohësisht, mbytjen maksimale të zhurmave, duke përdorur formula të thjeshta. Pra, ai duhet të nxjerrë në pah anomalitë e fiksuar me të gjitha metodat mbi të njëjtin trup. Sidomos, duhet të përforcojë anomalitë e dobëta dhe të zvogëlojë veprimin e anomalive (zhurmave) që kushtëzojnë nga objekti joperspektivë.

Për llogaritjen e parametrit kompleks  $T$ , njihen disa formula, të cilat marrin parasysh edhe llojet e ndryshme të trajtave të shfaqjes së sinjaleve të dobishme, që fiksohen me metoda të ndryshme mbi objektet xherore.

Ne kryem eksperimentin për rastin kur sinjalat e dobishme kanë trajtë afersisht të njëjtë, por shenjë të ndryshme. Si model na shërbeu një trup prizmatik kalkopiriti, me dy përmasa, i vendosur ndërmjet diabazeve. Trupi ka trashësi  $2b = 5$  m, zgjatet sipas rënies 50 m, ka kënd rënjeje vertikale dhe në rastin e parë, skaji i sipërm ndodhet 5 m. thellë, kurse në një rast të dytë, 25 m. thellë. Trupi ka dendësi mbetëse  $0.74 \text{ g/cm}^3$ , polarizueshmëri mbetëse  $38\%$  dhe magnetizëm mbetës  $1900 \times 10^{-6} \text{ CGSM}$ . Ai i është nënshtuar procesit të oksido-reduktimit (fig. 5).

Sic duket nga fig. 5, mbi trup fiksohen anomali të  $\Delta U_{FEN}$ ,  $Z$ ,  $W_{zz}$ , që janë shumë të dobëta kur trupi është vendosur në 25 m. thellë. Afër trupit xheror është supozuar edhe një tektonikë shkëputëse, e cila shkakton anomali intensive të FEN. Për të llogaritur parametrin kompleks përdorim formulën 5:

$$T = |A| + B + |C| + |D|, \quad (9)$$

Nga lakinja e përllogaritur e parametrit  $T$ , vihet re se përforcohet anomalia e dobët që shkaktohet nga trupi që gjendej 25 m thellë dhe shmanget anomali intensive të FEN.




Fig. 5: Anomalia e parametrit kompleks ( $T$ ) mbi një trup kalkopiriti, që është vendosur në thellësi të ndryshme.




Fig. 6: Prerje gjeologo-gjeofizike e një vendburimi me xehlerorë masivë sulfidë bakri, që lidhen me formacion efuzivo-sedimentar.

1 – Lakorja e parametrit kompleks T; 2 – lakorja e potencialit të fushës elektrike natyrore; 3 – lakorja e koeficientit të polarizimit të provokuar; 4 – lakorja e rezistencës së dukshme.

malia e FEN mbi tektonikën shkëputëse, e cila nuk është fiksuar me metoda tjetra.

Kur nuk kërkonhet të «shtypen» anomali «joxeherore», për të llogaritur parametrin  $T$  mund të përdoret edhe formula më e thjeshtë [5]:

$$T = |A| + |B| + |C| + \dots + |D|. \quad (10)$$

Bazë për programimin është formula 6. Por emëruesi i kësaj thyese ka rrevojë për t'u zhvilluar më tej.

Le të jenë  $B_1^i, B_2^i, \dots, B_m^i$ , vlerat e sfondit në zonën e fushës normale.

Atëhere, shhangja kuadratike mesatare e parametrit jebet nga formula:

$$S(A_i) = \sqrt{\frac{\sum_{k=1}^m (B_k^i - A)^2}{m-1}} \quad (11)$$

Të dyja këto formula (6, 11), programohen sipas parimeve të njëjta, që u paraqitën më sipër. Në program parashikohet, gjithashtu, edhe llogaritja e parametrit kompleks sipas formulave 9 ose 10. Të dhënat fillojnë futen në makinë pjesë-pjesë, sipas natyrës fizike të parametrit. Çdo grup të dhëna përbledh vlerat e parametrit,  $A_i$ , si edhe ato të sfondit të fushës normale  $B_k^i$ .

Me programin e hartuar u llogarit parametri kompleks  $T$  edhe sipas një profili që ndodhet mbi një vendburim sulfid bakri të njohur në rajonin e Kukësit (fig. 6). Për kërkimin e këtij vendburimi janë përdorur metodat gravimetrike, magnetometrike, të rezistencës së dukshme, e polarizimit të provokuar, fusha elektrike natyrore dhe gjeokimike. Nga lakinja e T e fig. 6 duket që me parametrin kompleks gjen pasqyrim të quartë vetëm trupi xehleror dhe «njëjishen anomalitë» joxeherore, për shembull të PK, 2 deri në 4.

Përveç këtij profili, parametri kompleks u llogarit edhe në një shesh të madh ku janë kryer studime komplekse për kërkimin e kromit dhe u muanë rezultate pozitive.

Është vënë re se, kur krahas metodave-gjeofizike, përdoren dhe studime gjeokimike, rezultate të mira merren në qoftë se është studjuar aureola parësore dhe mund të shfrytëzohet edhe aureola dytësore, po që se është e sheshtë; në rast të kundërt, ajo do të jetë e zhvendosur nga anomali gjeofizike dhe anomalia e parametrit  $T$  deformohet.

sipas profilimeve elektrike të kombinuara; 5 – lakinja e komponentit vertical të intensitetit të fushës magnetike; 6 – lakinja e forcës së gravititetit; 7 – lakinja e përbajtjes së bakrit në aureolën dytësore; 8 – rreshpe argiloro-strallore; 9 – diabaze; 10 – kapele hekuri; 11 – trup xehleror me teksturë masive; 12 – tektonikë shkëputëse.

## L I T E R A T U R A

- 1) Blloh. I.M. – Elektroprofilirovanie metodom soprotivlenia Moskva, 1962.
- 2) Frashëri A., Aliaj Sh., Sulstarova E., Avxhiu R. – Përdorimi i metodave gjeofizike zgjidhjen e detyrave gjeologjike. Botim i USHT, Tiranë, 1971.
- 3) Lubonja L, Frashëri A. – Metoda e polarizimit të provokuar dhe përdorimi i saj kërkimin e xeherorëve e për studimin e prerjeve të puseve. Botim i USHT, Tiranë, 1965.
- 4) Miller R., Kahn J. – Statistical Analysis in the Geological Sciences New-York-London, 1962.
- 5) Vahromjejev G.S., Shestakov J.G. – Obobshchenie rezultov geofizičeskikh i geokimicheskikh sjomok s pomoshju funkcií kompleksnovo pokazatela. Razvjetka i Ohrazeniye Njeda, Nr. 5, 1972.
- 6) Vllaho J., Vllaho E., Elezi E. – Rezultatet e gjertanishme të relievimeve metalometrike për kërkimin e bakrit dhe zgjedhja e një metodike më të përshtatshme për kushtet e rrethit të Kukësit. Përbledhje studimesh, Nr. 11, 1969.

Dorëzuar në redaksi  
në prill 1973

Fakulteti gjeologji-miniera i Universitetit të Tiranës.  
Qëndra llogaritëse elektronike,  
Tiranë.